



Procesverbal 12/2024

I mbajtur në mbledhjen e XII-të të Komitetit për Komunitete, në Kryesimin e Osman Eminit - Kryesues i Komitetit për komunitete, mbledhja u mbajt me datën **30.12.2024** në ora **11.00**, në zyrën e takimeve të Kryetari i komunës.

Rendi i ditës:

1. **Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e Komitetit për Komunitete;**
2. **Miratimi i rendit të ditës;**
3. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të Komitetit për Komunitete;**
4. **Vizitë Lagjes “Sallahane” dhe**
5. **Të ndryshme.**

Pika 1

Kryesuesi i Komitetit për komunitete Osman Emini – Konfirmoi pjesëmarrjen në mbledhje; prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për komunitete;

Pika 2

Kryesuesi i Komitetit për komunitete Osman Emini – U miratua rendi i ditës pa ndonjë vërejtje;

Pika 3

Kryesuesi i Komitetit për komunitete Osman Emini – Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.


Pika 4

Kryesuesi i Komitetit për komunitete Osman Emini – Vizituar Lagjen “Sallahane”, ishim në vizitë për të shikuar infrastrukturën e kësaj Lagje, vërejtëm se në Rrugën “Ejup Statovci” është bërë një asfaltim i rrugës me shtresën e parë dhe pritet që shtresa e dytë të filloj sa më parë, por kërkesa e banorëve të asaj Lagjeje ishte që në shtresën e dytë të bëhet edhe me polic të shtrirë për pengimin e shpejtësisë që zhvillohet në atë rrugë dhe rrezikon banorët e posaçërisht fëmijët, andaj ne si komitet mbështesim kërkesën e banorëve për policët e shtrirë.

Pika 5

Kryesuesi i Komitetit për komunitete Osman Emini – Të ndryshme, nuk ka diskutim, faleminderit për pjesëmarrje.

Procesmbajtës



Osman Emini

Kryesuesi i Komitetit për komunitete





Osman Emini